




Mbështetja e Shëndetit Mendor dhe Mirëqenies së Nxënësve

Të nderuar familjarë dhe kolegë,

Për shumëkënd, kjo periudhë e vitit lidhet me ngrohtësi, gëzim dhe festime, por njëherësh mund të sjellë edhe sfida reale për shëndetin dhe mirëqenien tonë mendore. Tani që dimri ka ardhur, me ditë më të shkurtra dhe temperatura më të ulëta, disa prej nesh mund të kenë nevojë për më shumë mbështetje për t'u ndier në formën më të mirë të mundshme.

Kjo është një nga arsyet pse vazhdojmë t'i japim përparësi mirëqenies mendore dhe emocionale të nxënësve tanë në Shkollat Publike të Nju-Jorkut (NYC Public Schools). Më poshtë gjeni disa nga burimet kryesore, të cilat ju nxis t'i ndani me të rinjtë në jetën tuaj:

- [NYC Teenspace \(Hapësira për adoleshentët\)](#) është një program falas që lidh të rinjtë e moshës 13-17 vjeç në Nju-Jork me mbështetje virtuale për shëndetin mendor nga terapistë të licencuar, përmes një platforme të sigurt online. Nxënësit dhe familjet mund të mësojnë më shumë në nyc.gov/teenspace.
- Thuajse 400 nga shkollat tona kanë akses në klinika të shëndetit mendor të bazuara në shkolla, të cilat u ofrojnë nxënësve trajtim klinik dhe shërbime për shëndetin mendor. Mësoni më shumë rreth këtyre klinikave në rubrikën Fokusi i kancelares dhe videon tonë përmbledhëse.

- Qindra shkolla të tjera bashkëpunojnë gjithashtu me organizata komunitare dhe/ose qendra shëndetësore të bazuara në shkolla, të cilat ofrojnë mbështetje për shëndetin mendor. Kontaktoni koordinatoren e prindërve në shkollën tuaj për të mësuar më shumë rreth bashkëpunimeve specifike të shkollës, si dhe për mbështetjen që mund të ofrojë stafi i shkollës, si këshilltarët dhe punonjësit socialë.
- Për të gjithë banorët e Nju-Jorkut, pavarësisht moshës, [NYC 988](#) është një burim falas për shëndetin mendor, i disponueshëm 24 orë në ditë përmes telefonit, mesazheve ose bisedave online.

Si gjatë këtij sezoni, ashtu edhe gjatë gjithë vitit, është thelbësore që t'i mbajmë nxënësit tanë të sigurt, fizikisht dhe emocionalisht. Në Shkollat Publike të Nju-Jorkut (NYC Public Schools), përkushtimi ynë ndaj sigurisë dhe mirëqenies së nxënësve është i palëkundur.

Në bashkëpunim,

Melissa Aviles-Ramos
Kancelare (Chancellor)

Fokusi i kancelares:

Klinikat tona të shëndetit mendor të bazuara në shkolla, të menaxhuara në bashkëpunim me partnerë komunitarë në të gjithë qytetin, ofrojnë mbështetje vendimtare për nxënësit tanë. Shikoni videon përmbledhëse për një pasqyrë më të thelluar të njërës prej këtyre klinikave, në Brooklyn International High School (Shkolla e Mesme Ndërkombëtare e Brooklyn).

Nominoni një person ose program për fokusin e kancelares [këtu](#).

Video përmbledhëse:



Për përkthime, ju lutemi vizitoni faqen tonë në [YouTube](#).

Për të aksesuar titrat e përkthyer: Klikoni mbi ikonën “CC”. Klikoni mbi ikonën “Settings (Cilësimet)” dhe zgjidhni “Subtitles/CC (Titrat/CC)”. Zgjidhni “Auto Translate (Përkthim Automatik)” dhe më pas zgjidhni gjuhën tuaj.

Lajme dhe burime nga NYCPS:

- Shihni [The Morning Bell](#) për një parashikim të [datave dhe ngjarjeve kryesore të dhjetorit](#).
- Për të reja dhe burime të tjera, ndiqni NYCPS online në [Facebook](#), [Instagram](#), [X](#) dhe [YouTube](#).
- Për përditësime javore me video nga Kryetari i Bashkisë Eric Adams, vizitoni faqen [YouTube të Zyrës së Kryetarit të Bashkisë](#). Mund gjithashtu [të regjistroheni për të marrë përditësime drejtpërdrejt nga Zyra e Kryetarit të Bashkisë](#).

Familje të NYCPS: Nëse nuk dëshironi më të merrni këtë buletin informativ, ju lutemi [çaktivizoni abonimin](#).